



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr. 37, datë 25.06.2014

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT KOMBËTAR
TË SISTEMIT TË PAGESAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, paragrafi 4, shkronja “dh”, nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 4 të ligjit nr. 133/2013, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave”, me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave dhe i Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave”, sipas tekstit bashkëlidhur vendimit.
2. Me zbatimin e vendimit ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe i Kontabilitetit dhe Financës në Bankën e Shqipërisë.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e rregullores në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI

KRYETARI

Elvis Çibuku

Gent Sejko

“MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMIT TË PAGESAVE”

Neni 1 Objekti

Objekti i rregullores është përcaktimi i qëllimit, funksioneve, detyrave, përbërjes, si dhe rregullave të organizimit dhe funksionimit të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, si organ kolegjal këshillimor.

Neni 2 Baza juridike

Komiteti krijohet dhe funksionon në bazë të akteve të mëposhtme:

- a) ligjit nr. 133/2013, datë 29.04.2013, “Për Sistemin e Pagesave”;
- b) ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe
- c) akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 3 Qëllimi

Komiteti ka qëllim që nëpërmjet veprimtarisë së tij, të mbështesë dhe të kontribuojë në rritjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri, në përmbushje të objektivit ligjor të Bankës së Shqipërisë për të nxitur funksionimin normal të sistemit të pagesave.

Neni 4 Përbërja

1. Komiteti përbëhet nga anëtarët me të drejtë vote, si më poshtë:
 - a) Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë, në cilësinë e Kryetarit të Komitetit;
 - b) Drejtori i Departamentit të Sistemeve të Pagesave dhe i Kontabilitetit dhe Financës në Bankën e Shqipërisë, në cilësinë e Zëvendëskryetarit të Komitetit;
 - c) një përfaqësues nga Kabineti i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, në cilësinë e Anëtarit;
 - d) Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, në cilësinë e Anëtarit;
 - e) “një përfaqësues në nivel ekzekutiv nga Ministrinë të cilat mbulojnë funksionet në vijim, në cilësinë e anëtarit¹:
 - i. thesarin e shtetit;
 - ii. të drejtën për të propozuar akte ligjore të hartuara nga Banka e Shqipërisë;

¹ Ndryshuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.24, datë 28.03.2018 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave””

- iii. mbrojtjen e konsumatorit;
 - iv. regjistrin e gjendjes civile;
 - v. luftës kundër krimit kibernetik;
 - vi. inovacionin dhe dixhitalizimin e shërbimeve publike (e-government);
 - vii. dërgesat e emigrantëve;
 - viii. si dhe funksione të tjera të cilat në varësi të objektivave dhe projekteve mund të ndërlidhen me funksionin e Komitetit.;
- f) shfuqizohet²;
 - g) shfuqizohet³;
 - h) shfuqizohet⁴
 - i) një përfaqësues në nivel drejtues nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në cilësinë e Anëtarit;
 - j) Kryetari i Shoqatës së Bankave, në cilësinë e Anëtarit;
 - k) Kryetari i Komitetit të Pagesave pranë Shoqatës Shqiptare të Bankave, në cilësinë e Anëtarit.
 - l) “një përfaqësues në nivel ekzekutiv nga institucionet financiare jo-banka të cilat kryejnë veprimtarinë e transfertave dhe pagesave dhe /ose të parasë elektronike dhe operatorët e infrastrukturës, të licencuar në bazë të ligjit “Për Sistemin e Pagesave”, në cilësinë e Anëtarit; përfaqësuesit mund të marrin pjesë në mbledhje me përfaqësim ose në formë individuale.”⁵;

2. Në mbledhjen e Komitetit marrin pjesë edhe:

- a) Sekretariati i Komitetit, i përbërë nga të paktën një punonjës i Departamentit të Sistemeve të Pagesave dhe i Kontabilitetit dhe Financës dhe i Departamentit Juridik në Bankën e Shqipërisë, në cilësinë e pjesëmarrësve pa të drejtë vote; dhe
- b) Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave, në cilësinë e pjesëmarrësit pa të drejtë vote.

3. Në mbledhjen e Komitetit, në varësi të tematikave të përcaktuara në rendin e ditës, mund të marrin pjesë si vëzhgues aktorë të tjerë kryesorë të sistemit të pagesave dhe infrastrukturës së tregjeve financiare të tillë si: shoqëritë utilitare, shoqëritë e telekomunikacionit, përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës, ekspertë të huaj të fushës së sistemeve apo shërbimeve të pagesave etj⁶

² Shfuqizuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.24, datë 28.03.2018 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave””

³ Shfuqizuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.24, datë 28.03.2018 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave””

⁴ Shfuqizuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.24, datë 28.03.2018 për disa ndryshime në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave “

⁵ Ndryshuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.24, datë 28.03.2018 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave””

⁶ Ndryshuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.24, datë 28.03.2018 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave””

4. Sekretariati i Komitetit, në rastet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, me propozimin e të paktën një anëtari dhe/ose dërgimin e kërkesës nga subjekti i interesuar në adresën elektronike “komitetiKSP@bankofalbania.org” dhe me miratimin e drejtuesit të mbledhjes, kujdeset për komunikimin në kohë të arsyeshme të këtij vendimi tek subjekti i interesuar për të marrë pjesë, në mënyrë që të garantohet pjesëmarrja në kohë. Personi i ftuar nuk ka të drejtë vote në mbledhjen e Komitetit.⁷
5. Çdo anëtar i Komitetit, në varësi të tematikës së seancës, mund të shoqërohet në mbledhje nga një ose disa nëpunës nga institucioni që përfaqëson, duke njoftuar paraprakisht Sekretariatit, i cili përcjell informacionin pranë drejtuesit të mbledhjes. Nëpunësi/it shoqëruar nuk ka të drejtë vote në mbledhjen e Komitetit.
6. Anëtarët e Komitetit përcaktohen nga institucionet pjesëmarrëse në këtë Komitet, me kërkesë të Bankës së Shqipërisë.
7. Përbërja e Komitetit mund të rishikohet në varësi të zhvillimeve të tregut dhe objektivave të përcaktuar në fushën e sistemit të pagesave.

Neni 5

Funksionet

1. Për realizimin e qëllimit të përcaktuar në nenin 3 të rregullores, Komiteti ushtron funksionet e mëposhtme:
 - a) këshillon kryesisht organet vendimmarrëse të Bankës së Shqipërisë për çështje të sistemit të pagesave dhe të përdorimit të instrumenteve të pagesave;
 - b) këshillon organet vendimmarrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për çështje të licencimit dhe të mbikëqyrjes së sistemit të shlyerjes së titujve dhe të shtëpisë së klerimit të titujve;
 - c) këshillon institucionet pjesëmarrëse për çështje në lidhje me sistemet dhe instrumentet e pagesave;
 - d) këshillon institucionet pjesëmarrëse me qëllim promovimin dhe standardizimin e proceduarve dhe sistemeve të pagesave;
 - e) harton pozicione të përbashkëta, deklarata dhe udhëzime, me aktorët e tregut, për çështje strategjike të sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes;
 - f) nxit dhe lehtëson bashkëpunimin e nevojshëm ndërmjet palëve të interesuara në fushën e sistemit të pagesave dhe infrastrukturës së tregjeve financiare;
 - g) identifikon nevojat infrastrukturore dhe juridike në fushën e sistemit të pagesave duke dhënë rekomandime/sugjerime, si dhe sipas rastit ngre grupe pune, të cilat mbështesin procesin vendimmarrës të Komitetit për këto qëllime;
 - h) analizon dhe diskuton inovacionet dhe praktikat/standardet më të mira ndërkombëtare në fushën e sistemit të pagesave duke vlerësuar rast pas rasti mundësinë e zbatimit të tyre në tregun shqiptar, si dhe ndikimet që krijohen në treg nga implementimi i tyre;
 - i) informon dhe diskuton me institucionet pjesëmarrëse, si dhe me aktorët e tregut financiar, mbi të rejtat e fundit në fushën e përafrimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian;

⁷ Ndryshuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.24, datë 28.03.2018 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave””

- j) harton politika/strategji me qëllim që të mbështesë rritjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri, duke përcaktuar objektivat dhe duke monitoruar dhe vlerësuar ndikimin që ato kanë në treg, si dhe zbatimin e tyre;
 - k) bashkëpunon, direkt apo indirekt, me autoritete vendase apo të huaja, me qëllim shkëmbimin e informacioneve apo bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me fushën e sistemit të pagesave në bazë të memorandumeve të bashkëpunimit të lidhura me këto autoritete; dhe
 - l) çdo lloj funksioni tjetër që i shërben qëllimit ligjor të krijimit të tij.
2. Komiteti përgatit dhe publikon në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë një informacion përmbledhës të veprimtarisë së tij bazuar në mbledhjet e kryera gjatë periudhës.

Neni 6 Mbledhja

1. Komiteti mbledhet si rregull të paktën 1 herë në vit, si dhe me kërkesë të anëtarëve me të drejtë vote, të përcaktuar në nenin 4, pika 1, sa herë gjykohet e nevojshme.”⁸
2. Mbledhja e Komitetit drejtohet nga Kryetari dhe në rast se kryetari mungon ose është në pamundësi për të ushtruar kompetencat, zëvendëskryetari merr dhe ushtron kompetencat e tij.
3. Komiteti, mbledhet nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Në rast pamundësie pjesëmarrjeje, anëtarët i komunikojnë paraprakisht Sekretariatit, përfaqësuesin e tyre, i cili merr pjesë në mbledhje pa të drejtë vote.
4. Pjesëmarrësit në mbledhje i përcjellin zhvillimet e mbledhjes nivelit drejtues të institucionit të cilin përfaqësojnë.

Neni 7 Kompetencat e Kryetarit

Kryetari i Komitetit ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) drejton mbledhjen;
- b) cakton ditën e mbledhjes;
- c) miraton rendin e ditës për çdo mbledhje, të përgatitur nga Sekretariati, me propozime kryesisht nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe i Kontabilitetit dhe Financave, dhe/ose çështje të propozuara nga anëtarët;
- d) miraton pjesëmarrjen e përfaqësuesve të subjekteve të interesuara sipas pikës 3 të nenit 4 të rregullores;
- e) nënshkruan vendimet e Komitetit; dhe
- f) orienton në përgjithësi veprimtarinë e punës së Komitetit, për realizimin e qëllimit të tij.

⁸ Ndryshuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.24, datë 28.03.2018 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave””

Neni 8

Kompetencat e Sekretariatit

1. Sekretariati i Komitetit ushtron detyrat e mëposhtme:
 - a) mbledh propozimet, përgatit rendin e ditës për mbledhjen dhe e dërgon për miratim pranë Kryetarit të Komitetit;
 - b) përgatit shkresat dhe dokumentacionin e nevojshëm për organizimin e mbledhjes;
 - c) vë në dispozicion të çdo pjesëmarrësi rendin e ditës të shoqëruar me materialet përkatëse, të paktën 10 (dhjetë) ditë pune para ditës së mbledhjes;
 - d) mban procesverbalin e mbledhjes, i cili miratohet nga Komiteti në një periudhë kohore të arsyeshme për përmbushjen e procedurave, pas zhvillimit të mbledhjes. Procesverbali përmban të paktën:
 - i. datën dhe orën e zhvillimit të mbledhjes,
 - ii. emrat e të gjithë pjesëmarrësve në mbledhje (drejtuesin, anëtarët, të ftuarit, etj),
 - iii. çështjet që shqyrtohen, dhe nëse është rasti, konfidencialitetin e tyre, të përcaktuara nga Komiteti,
 - iv. llojin dhe burimin e materialeve që paraqiten në mbledhje për shqyrtim,
 - v. personat që diskutojnë dhe objektin e diskutimit të tyre,
 - vi. propozimet që kalojnë për votim,
 - vii. kryerjen ose jo të votimit dhe rezultatin e tij, duke përfshirë votat pro dhe kundër me argumentimet përkatëse,
 - viii. konkluzionet e mbledhjes,
 - ix. etj;
 - e) përgatit vendimin/ konkluzionin (propozimet/rekomandimet/sugjerimet) e marra nga Komiteti në të paktën 2 (dy) kopje, një prej të cilave e mban vetë dhe tjetrën ia vë në dispozicion Kryetarit për t'ia përcjellë Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, apo institucioneve të tjera, në varësi të tematikës;
 - f) mirëmban dhe përditëson materialet për publikim në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë;
 - g) përgatit informacionin përmbledhës mbi veprimtarinë e Komitetit dhe e dërgon për mendim tek anëtarët, me qëllim miratimin e tij; dhe
 - h) çdo detyrë tjetër që i shërben mbarëvajtjes së punës së Komitetit dhe që i caktohet nga Kryetari.

Neni 9

Vendimmarrja

1. Vendimet e Komitetit synohet të merren me dakordësinë e të gjithë anëtarëve. Në rast të kundërt, vendimi merret me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

2. Vota e drejtuesit të mbledhjes është përcaktuese në ndarjen/numërimin e votave pro dhe kundër në mënyrë të barabartë. Mendimet kundër pasqyrohen në mënyrë nominative dhe të detajuar në procesverbalin e mbledhjes.
3. Vendimi i Komitetit nënshkruhet nga Kryetari, anëtarët e pranishëm dhe Sekretariati, në 2 (dy) kopje, një prej të cilave e mban Sekretariati dhe tjetrën ia vë në dispozicion Kryetarit për t'ia përcjellë Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, apo institucioneve të tjera, në varësi të tematikës.
4. Vendimet e Komitetit nuk janë detyruese për institucionet pjesëmarrëse, por kanë karakter këshilluese, bazuar në qëllimin për të cilin është krijuar ky Komitet.

Neni 10 **Grupet e punës**

1. Komiteti mund të vendosë që për çështje të caktuara të ngrihen grupe pune me ekspertë të fushës. Vendimi për ngritjen e grupeve të punës u dërgohet pjesëmarrësve të caktuar, në varësitë objektit që mbulon secili institucion. Institucionet përkatëse angazhohen të finalizojnë ngritjen e grupeve të përbashkëta pune, nëpërmjet akteve përkatëse.
2. Komiteti përcakton drejtuesin e grupit të punës, objektivat, afatet dhe mënyrën e raportimit pranë Komitetit.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës